



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 13 Prill 2021

Nr: 232

VENDIM

PËR

MIRATIMIN E VËZHguesve AFATSHKURTËR DHE PËRKTHYESVE TË AMBASADËS BULLGARE, TË AMBASADËS SPANJOLLE DHE TË AMBASADËS HOLLANDEZE PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË, TË DATËS 25 PRILL 2021.

Në mbështetje të neneve 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe Udhëzimit nr.2, datë 02.02.2021 “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, mediave dhe subjektet zgjedhore”, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

VENDOS:

1. Të miratojë kërkesën e Ambasadës Bullgare për akreditimin e 3 (tre) vëzhguesve afatshkurtër dhe për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021 sipas lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të miratojë kërkesën e Ambasadës Spanjolle për akreditimin e 4 (katër) vëzhguesve afatshkurtër dhe 2 (dy) përkthyesve për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021 sipas lidhjes 2, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Të miratojë kërkesën e Ambasadës Hollandeze së Veriut për akreditimin e 3 (tre) vëzhguesve afatshkurtër për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021 sipas lidhjes 3, bashkëlidhur këtij vendimi.



4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Ilirjan CELIBASHI

